

KOMUNA E STRUGËS



**STRATEGJIA PËR
BASHKËPUNIM ME
SEKTORIN QYTETAR
2015-2020**

STRATEGJIA
BASHKËPUNIM ME
SEKTORIN QYTETAR
2015-2020

KOMUNA E STRUGËS



**STRATEGJIA E
KOMUNËS SË STRUGËS PËR
BASHKËPUNIM ME
SEKTORIN QYTETAR
2015-2020**

Botues:

Komuna e Strugës

Për botuesin:

Ziadin Sela, Kryetar i Komunës

Përktheu në gjuhën shqipe:

Ismail Krifca

Lekturoi dhe korrigjoi tekstin:

Luljeta Ademi

Grafika dhe dizajni:

Brigada dizajn

Shtypi:

Propoint

Tirazhi:

500 kopje

Tirazh falas / jo komercial

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352.08:316.453(497.772)"2015/2020"

СТАРТЕГИЈА на Општина Струга за соработка со граѓанскиот сектор :

2015-2020. - Струга : Општина Струга, 2015. - 38 стр. ; 20 см

Насл. стр. на припечатениот текст: STRATEGJIA E KOMUNËS STRUGË PËR BASHKËPUNIM ME

SEKTORIN QYTETAR 2015 – 2020- Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. -

Текст на мак. и алб. јазик.

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65849-1-7

а) Локална самоуправа - Граѓански сектор - Соработка - Струга -

2015-2020 б) Развој на општините - Невладини организации - Стратегији - Струга - 2015-2020

COBISS.MK-ID 98745866



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
 OPEN OTBOPENO
 SOCIETY YIOIШTECTBO
 MACEDONIA MAKЕДОНИЈА

**Përgatitja e Strategjisë është
 mbështetur financiarisht nga
 Fondacioni Shoqëria e Hapur-Maqedoni.**

1. Përmbledhje ekzekutive	7
2. Hyrje	9
3. Vizioni	13
4. Parimet dhe vlerat	14
5. Politikat rrjedhëse për bashkëpunim me sektorin qytetar	16
6. Harta strategjike	21
7. Prioritetet dhe masat strategjike të Komunës së Strugës për bashkëpunim me sektorin qytetar	23
7.1 Menaxhimi me buxhetin.....	23
7.2 Ngritja (zhvillimi) e kapaciteteve.....	24
7.3 Sigurimi i shërbimeve.....	25
7.4 Qytetarë të kënaqur.....	26
8. Harta e balancuar e treguesve të Komunës së Strugës për bashkëpunim me sektorin qytetar	27
9. Monitorimi dhe vlerësimi	32

Lista e shkurtesave

- SQ**.....Sektori Qytetar
- KE**.....Komisioni Evropian
- NjVL**.....Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
- BE (UE)**.....Bashkimi Evropian (Unioni Evropian)
- SQ**.....Sektori Qytetar
- HBT**.....Harta e Balancuar e Treguesve
- TIK**.....Teknologjia Informative - Komunikuese
- OJQ**.....Organizata Joqeveritare
- PEST**.....Analiza politike – legjislativë, ekonomike, sociale dhe teknologjike
- RM**.....Republika e Maqedonisë
- SVOT**.....Analiza e anëve të fuqishme, anëve të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (rreziqeve)
- FShHM**.....Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedoni
- OKB**.....Organizata e Kombeve të Bashkuara

Në këtë dokument shfrytëzohen termet dhe shprehjet për sektorin qytetar (SQ) të cilat në varësi prej shfrytëzimit të tyre të përditshëm në sektorët e ndryshëm në shoqëri, mund të çojnë te perceptimi i ndryshëm i të njëjtave. Përkufizimi i përgjithshëm i pranuar juridik për organizatat qytetare nuk ekziston, por gjithsesi, sipas të kuptuarit të Organizatës të Kombeve të Bashkuara (OKB), organizatat qytetare janë: “Grupe qytetare jofitimprurëse, vullnetare të cilat organizohen në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të ngritjes së çështjeve me interes publik. Të orientuara sipas qëllimit dhe të formuara nga njerëzit me interesa të përbashkëta, ata kryejnë shërbime dhe funksione humanitare të ndryshme, i përfaqësojnë nevojat e qytetarëve para qeverive, i ndjekin politikat dhe realizimin e programeve dhe mbështesin pjesëmarrjen e sektorit qytetar në nivel të komunitetit¹. Nga ana e tij, madje, Civikus² e përkufizon shoqërinë qytetare si hapësirë midis familjes, shtetit dhe tregut, ku njerëzit bashkohen që të realizojnë interesat e tyre prej nga shikohet se përkufizimi ka për qëllim të përfshijë si bashkimin formal ashtu edhe atë joformal dhe rrjetet.

Për qëllim të mirëkuptimit dhe dallimit të qartë të shprehjeve të shfrytëzuara në këtë dokument, duhet të kemi në konsiderim shpjegimet vijuese:

1. **Shoqëria qytetare** – asociacione, organizata dhe rrjete formale dhe joformale qytetare duke përjashtuar këtu familjet, biznes sektorin, partitë politike dhe sektorin qytetar, ndërsa formohen me qëllim që të shprehin dhe realizojnë qëllimet dhe interesat e përbashkëta.
2. **Organizatë** – secila shoqatë, fondacion, bashkim dhe secila formë organizative e organizatës së huaj, si edhe formë e bashkimit, e regjistruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqatat dhe Fondacionet;
3. **Organizata me status të interesit publik** – është organizatë e cila ka fituar statusin e organizatës me interes publik në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet;

¹ Burimi: Kombet e Bashkuara, Zyra për Bashkëpunim me Organizatat Qytetare, Departamenti për Marrëdhëniet me Popullatën.

² Civikus, 2003. Civikus – Aleanca Botërore për Pjesëmarrje Qytetare është organizatë qytetare ndërkombëtare e themeluar në vitin 1993 me seli në Uashington dhe Johannesburg, misioni i së cilës është që të përforcojë aksionin qytetar dhe shoqërinë qytetare në botë.

4. **Sektori qytetar** – organizatat e regjistruara në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet. Strategjia e shfrytëzon nocionin organizata qytetare, shoqata qytetare, shoqëri qytetare, organizata joqeveritare të cilat i referohen përcaktimit më të ngushtë si sinonim për shoqatat dhe fondacionet, gjegjësisht me një fjalë sektori qytetar
5. **Palët e interesuara** – grupe qëllimore qytetare, organizata dhe institucione të cilat kanë interes dhe ndikim në sektorin qytetar.
6. **Grupi qëllimor (target grupi)** për të cilin kryesisht kanë të bëjnë masat e kësaj strategjie janë të gjithë subjektet e formuar në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet, gjegjësisht sektori qytetar (SQ) të cilat veprojnë në rajonin e Komunës së Strugës.
7. **Komuna** – njësia e vetëqeverisjes lokale, si komunitet i banorëve në një rajon të caktuar, përcaktuar me ligj, e cila nëpërmjet të organeve të saj dhe administratës së saj dhe shërbimeve publike të organizuara, mundëson kryerjen e kompetencave të parashikuara me ligj.
8. **Teknologjitë informative – komunikuese (TIK)** – grumbull i teknologjive të cilat merren me përpunimin, ruajtjen dhe komunikimin e informatave, përfshirë këtu të gjitha llojet e sistemeve kompjuterike dhe komunikuese.
9. **Harta strategjike** (nga gjuha angleze *Strategic Map*) – struktura logjike e cila tregon lidhshmërinë logjike të shkakut dhe pasojës midis qëllimeve prioritare strategjike.
10. **Harta e balancuar e treguesve (HBT)** (nga gjuha angleze *Balance Score Card*) është metodë bashkëkohore e planifikimit strategjik dhe menaxhimit e cila shfrytëzohet në biznes sektorin, sektorin publik dhe organizatat jofitimprurëse.
11. **Kompetencë** – përmbledhje e punëve me interes publik me domethënie lokale, të cilat komuna – në përputhje me ligjin – ka të drejtë t'i realizojë në sferën e saj dhe është përgjegjëse për realizimin e tyre.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Procesi i planifikimit strategjik është i përpiluar me qëllim që të: ndërtojë vizionin e përbashkët për të ardhmen; të vendosë prioritetet; të fokusojë energjinë dhe resurset në komunë; dhe të sigurojë që këshilltarët, krytari i komunës dhe të punësuarit dhe palët e tjera të interesuara të cilët janë pjesëmarrës në proces të punojnë në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

Harta Strategjike e Komunës së Strugës për bashkëpunim me sektorin qytetar (SQ) e tregon rrugën në të cilën komuna mund të arrijë vizionin për zhvillim, vendin dhe rolin e SQ në komunë në periudhën 2015 – 2020. Njëpërmjet Hartës së Balancuar të Treguesve (HBT)³, dokumenti i siguron qëllimet me prioritet, treguesit kryesorë për arritjen e tyre, vlerat qëllimore të cilat dëshirohen të arrihen si edhe masat dhe iniciativat të cilat duhet të sigurojnë arritjen e tyre.

Ndjekja e përpiktë dhe realizimi i masave dhe iniciativave të përmbytura në dokumentin nga ana e kryetarit të komunës, administratës komunale dhe Këshillit komunal, si edhe mbështetja adekuate do të sigurojë arritjen e vizionit dhe besimin në dedikimin, transparencën dhe efikasitetin e komunës së Strugës për bashkëpunimin me sektorin qytetar.

Procesi gjithëpërfshirës strategjik i planifikimit mundësoi që të definohet vizioni dhe prioritetet strategjike të grupuara lidhur me katër perspektivat nga Fletënotimet e balancuara të treguesve (kënaqësisë së qytetarëve, ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e kapaciteteve dhe menaxhimit të buxhetit.



Sektori qytetar në Strugë është partner kryesor i administratës për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mjediset urbane dhe rurale duke shfrytëzuar parimet e demokracisë pjesëmarrëse.

³ Kaplan, R. dhe Norton, D., The Balanced Scorecard, Measures that Drive Performance, Harvard Business Review (1992)

Prioritetet strategjike në Komunë në secilën perspektivë janë:

■ QYTETARËT E KËNAQUR

- **QK1:** SQ i rrjetëzuar që merr pjesë na mënyrë aktive në proceset e bartjes së politikave/ vendimeve në nivel lokal
- **QK2:** Përmirësimi i sigurimit të shërbimeve lokale me shfrytëzimin e kapaciteteve të SQ-së

■ SIGURIMI I SHËRBIMEVE

- **SSh1:** Vendosja e sistemit intern efikas dhe të qëndrueshëm për bashkëpunim të suksesshëm me SQ-në
- **SSh2:** Vendosja e sistemit funksional dhe transparent për qasjen deri te informatat

■ ZHVILLIMI I KAPACITETEVE

- **ZhK1:** Përforcimi i përbashkët sistematik dhe i vazhdueshëm i kapaciteteve të administratës komunale dhe SQ

■ MENAXHIMI ME BUXHETIN

- **MB1:** rritja e burimeve të jashtme të mjeteve për mbështetjen e projekteve të SQ-së
- **MB2:** sigurimi i konsistencës të buxhetit komunal dedikuar SQ-së
- **MB3:** efikasiteti i shtuar në shfrytëzimin e buxhetit të komunës për SQ.

Strategjia për bashkëpunim me shoqërinë civile për periudhën 2015 - 2020 është miratuar nga Këshilli i Komunës së Strugës në shkurt 2015.

HYRJE

Krijimi dhe mirëmbajtja e mekanizmave institucionalë për bashkëpunimin e qytetarëve dhe organeve dhe trupave lokale, dhe në veçanti në proceset e krijimit të politikave lokale e jep bazën e demokracisë pjesëmarrëse. Përfshirja e popullatës në krijimin e politikave lokale nënkupton edhe mobilizimin e tyre dhe krijimin e kushteve për të shprehur mendimet dhe interesat e ndryshme. Komuna e Strugës në tërësi e kupton rëndësinë e sektorit qytetar në zhvillimin e proceseve demokratike në komunë dhe në përgjithësi në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës në komunitet. Duke u nisur nga këto fakte, Komuna e Strugës vendosi që të nxit aktivizmin qytetare në komunë, të avancojë bashkëpunimin me organizatat qytetar dhe të kontribuojë në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm. Rezultat i kësaj përpjekje është ky dokument “*Strategjia e e Komunës së Strugës për bashkëpunimin me sektorin qytetar 2015 – 2020*” dhe i njëjti ka të bëjë me bashkëpunimin me shoqatat dhe fondacionet, si pjesë e sektorit më të gjerë qytetar, dhe ka për qëllim të sigurojë proces përfshirës dhe pjesëmarrjen e sektorit qytetar në proceset e përcaktimit të aktiviteteve zhvillimore dhe iniciativave të komunës së Strugës, si edhe të krijojë parakushte për themelimin e partneriteteve efikase.

Strategjia e Komunës së Strugës për bashkëpunim me sektorin qytetar është përgatitur në mënyrë konsultative dhe pjesëmarrëse me përfshirje të rëndësishme të organizatave qytetare dhe administratës komunale në periudhën mars – nëntor të vitit 2014⁴.

⁴ Përgatitja e Strategjisë e mbështetur nga Fondacioni shoqëria e hapur - Maqedoni (FOSM), si pjesë e konceptit “Komuna sipas masës/terkut të qytetarëve”, e cila është zbatuar në periudhën v.2014-2017. Qëllimi është rritja e kapacitetit administrativ dhe financiar të komunës, forcimin e shoqërisë civile për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën dhe kontributin e komunitetit për qeverisje të mirë në shkollë. Në kuadër të konceptit të “Komuna sipas masës/terkut të qytetarëve” është e hapur Qendër për komunitetin në Komunën e Strugës, i cili siguron ndihmë ligjore dhe administrative për qytetarët, edukim jo-formal për të rinjtë dhe të rriturit dhe hapësirë për aktivitete të klubeve rinore dhe iniciativa të tjera kulturore dhe qytetare. Për transparencë më të madhe dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve në punën e Këshillit të Komunës së Strugës, është siguruar mbështetje për reorganizimin e sallës për mbledhje.

Krijimi i parakushteve cilësore, dedikimi i strukturave më të larta udhëheqëse të komunës dhe motivimi i palëve të interesuara për pjesëmarrje në procesin janë faktorët kryesorë për planifikimin strategjik të suksesshëm. Në këtë drejtim ishte siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dedikim dhe pjesëmarrje aktive e anëtarëve të këshillit dhe administratës së komunës në procesin e krijimit të strategjisë. Gjegjësisht, procesi i krijimit të strategjisë ishte paraprakisht i mbështetur me një varg të trajnimeve për: (1) përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale për: planifikimin strategjik me shfrytëzimin e Hartës së Balancuar të Treguesve, krijimin e politikave për pjesëmarrje, financimin prej fondeve të BE-së dhe strategjitë komunikuese; (2) organizatat qytetare për kuptimin më të mirë të kompetencave komunale, fondeve të BE-së dhe politikat për antidiskriminim; dhe (3) shkolla për menaxhimin demokratik, drejtësinë sociale dhe përpilimin e planeve shkollore. Procesit të planifikimit strategjik i paraprinte përpilimi i analizës gjithëpërfshirëse për gjendjen rrjedhëse të komunës, e cila ishte realizuar nëpërmjet të pyetësorëve dhe intervistave me të gjitha palët e interesuara nga administrata komunale dhe përfaqësuesit e SQ-së, si edhe analiza e ekzistimit të dokumenteve relevante⁵. Në procesin e përpunimit të Strategjisë ishin marrë në konsiderim të gjitha dokumentet ekzistuese strategjike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Procesit vazhdoi me organizimin e tre debateve publike me qëllim që të sigurohet një shqyrtim i hapur dhe harmonizimi i politikave dhe prioriteteve dhe masave të propozuara strategjike dhe rritja e fokusimit dhe përgjegjësisë në procesin e implementimit të saj. Planifikimi strategjik bazohej në shfrytëzimin e modelit të Hartës së balancuar të treguesve dhe në mënyrë kronologjike përbëhej prej:

- trajnimeve për palët e interesuara,
- analizës gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale në komunë për bashkëpunim me sektorin qytetar,
- hulumtimi në terren për kënaqësinë e qytetarëve prej shërbimeve lokale të komunës,

⁵ Raporti për gjendjen vijuese në Komunën Strugë (arsimi, sociale, rinia dhe bashkëpunimi me sektorin qytetar), FShHM, maj 2013

- analiza e palëve të interesuara,
- PEST-analiza,
- SWOT/TOWS-analiza,
- formulimi i vizionit,
- identifikimi i parimeve dhe vlerave,
- përcaktimi i qëllimeve të prioriteteve strategjike,
- përpilimi i hartës strategjike,
- përcaktimi i treguesve kryesorë të performancës,
- përcaktimi i vlerave qëllimore për secilin tregues kryesor të performancës,
- identifikimi i masave dhe aktiviteteve për arritjen e vlerave qëllimore,
- përpilimi i hartës së balancuar të treguesve,
- përpilimi i Projekt-versionit të Strategjisë,
- debat publik,
- miratimi i Strategjisë nga ana e Këshillit të Komunës.

Strategjia është përpiluar në bazë të raportit për gjendjen e kuzistuese në Komunën e Strugës, si edhe Analiza Strategjike të cilat janë dhënë si dokumente shoqëruese të strategjisë. Strategjia do të jetë e shoqëruar me planin aksionar, i cili do të përpujë aktivitetet konkrete dhe do të kontribuojë në përmbushjen e prioriteteve dhe masave të caktuara strategjike në drejtim të arritjes së vizionit të komunës.

Dokumenti është në përputhje me:

- Strategjinë për Bashkëpunim të Qeverisë me Sektorin Qytetar (2012 – 2017);
- Planin Aksionar për realizimin e Strategjisë për Bashkëpunimin e Qeverisë me Sektorin Qytetar (2012 – 2017);
- Programi për realizimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillimi i vetëqeverisjes lokal në Republikën e Maqedonisë (2011 – 2014);
- Programi për zhvillimin e rajonit planifikues veriperëndimor (2010 – 2015);
- Plani Strategjik për Zhvillimin e Komunës së Strugës dhe Plani Aksionar për Strategjinë për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunës Strugë (2007 – 2011).

VIZIONI



SEKTORI QYTETAR NË STRUGË ËSHTË PARTNERI KRYESOR I ADMINISTRATËS SË KOMUNËS NË PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË JETËS NË MJEDISËT URBANE DHE RURALE DUKE SHFRYTËZUAR PËRIMET E DEMOKRACISË PJESËMARRËSE

Ky vizion i Komunës së Strugës do të realizohet nëpërmjet sigurimit të konsistencës dhe parashikimit të mjeteve financiare prej buxhetit të komunës të dedikuar për sektorin qytetar në komunë dhe së bashku me sektorin qytetar do të punojmë në përforcimin e ndërsjellë të kapacitetit administrativ dhe profesional. Nëpërmjet prezantimit të sistemit të qëndrueshëm dhe efikas të brendshëm për bashkëpunim me sektorin qytetar dhe sistemit funksional për qasje deri te informatat do të stimulojmë demokracinë pjesëmarrëse për avancimin e zhvillimit ekonomik, trashëgimisë sociale- kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

PARIMET DHE VLERAT

Në procesin e realizimit të prioriteteve dhe masave strategjike për realizimin e vizionit të Komunës së Strugës për bashkëpunim me sektorin qytetar në periudhën 2015 – 2020 do të respektohen parimet dhe vlerat vijuese:

- **Barazia:** në implementimin e strategjisë komuna do të ketë marrëdhënie të njëjta ndaj të gjithë qytetarëve dhe shoqatave të tyre pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, fetare, gjinore, të moshës ose përkatësisë tjetër.
- **Transparencë:** do të promovohet nivel i lartë i transparencës së informatave me të cilat disponon, shërbimet të cilat i ofron, procedurat sipas të cilave realizohen dhe kriteret sipas të cilëve të njëjta mundësohen.
- **Llogaridhënie:** llogaridhënie për punën e pushtetit lokal (Kryetarit të komunës, Këshillit dhe administratës) çfarë është realizuar, por edhe çfarë nuk është realizuar në kuadër të programeve të parashikuara komunale me raporte të detajuara financiare të programeve të realizuar, projekteve, masave dhe aktiviteteve.
- **Pjesëmarrje:** qytetarët dhe shoqatat qytetare do të jenë në mënyrë aktive të përfshirë jo vetëm në procesin e konsultimeve, por edhe në krijimin e politikave publike me rëndësi lokale.
- **Profesionalizëm:** aktivitetet do të realizohen duke punuar në mënyrë objektive dhe duke ndjekur normat dhe procedurat e përcaktuara.
- **Inoviteti:** pandërprerë do të kërkohen ide të reja të cilat do të shpalojnë në prodhime ose shërbime të reja të cilat do të stimulojnë zhvillimin dhe krijimin e vendeve të punës.

- **Ligjshmëri:** gjatë realizimit të të gjitha aktiviteteve të parashikuara me strategjinë do të respektohen ligjet e Republikës së Maqedonisë.
- **Etika:** në përmbushjen e qëllimeve do të nisët nga parimet e parashikuara me Kodin etik të nëpunësve shtetëror të RM-së dhe Kodin e praktikave të mira për pjesëmarrjen e sektorit qytetar në krijimin e politikave.
- **Partneritet:** në implementimin e prioriteteve strategjike do të ndërtohen partneritete me sektorin tjetër publik dhe biznes sektorin, si edhe informimi dhe përfshirja e palëve të interesuara.

POLITIKAT RRJEDHËSE PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN QYTETAR

Analiza strategjike tregoi se ndikimin më të madh prej faktorëve të jashtëm mbi bashkëpunimin e vetëqeverisjes lokale me sektorin qytetar e kanë faktorët politikë-legjislativë dhe ekonomikë, si edhe praktika e vendosur e administratës komunale për bashkëpunim si faktor i brendshëm më i rëndësishëm.

Faktorët e jashtëm

Me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet⁶ rregullohen mënyra, kushtet dhe procedura për themelimin, regjistrimin dhe ndërprerjen e shoqatave, fondacioneve, unioneve, formave organizative të organizatave të huaja në Republikën e Maqedonisë, pronën me të cilën disponojnë ata, mbikëqyrjen, ndryshimet statutore dhe statusin e organizatave me interes publik. Këshillat e komunave kanë obligim që për më së afërmi të rregullojnë kushtet për shpërndarjen dhe shfrytëzimin e mjeteve të cilat do t'i transferojnë deri te organizatat dhe të miratojnë planet dhe programet vjetore për shpërndarjen e mjeteve, si edhe publikisht të shpallin organizatat të cilat kanë fituar mjete financiare në ueb faqen e komunës. Me ligj përcaktohet statusi i interesit publik, që domethënë se organizatat mund të fitojnë statusin e interesit publik vetëm nëse kryejnë veprime me interes publik, realizimin e programeve dhe projekteve në nivel qendror dhe/ ose lokal, në mënyrë vetjake ose në bashkëpunim me organet e administratës shtetërore dhe organet e komunës, si edhe shfrytëzimin e mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve.

Strategjia e parë kombëtare për bashkëpunimin e Qeverisë me organizatat qytetare ishte e miratuar në janar të vitit 2007, së bashku me Planin Aksionar në të cilin ishin përpiluar masat dhe aktivitetet specifike për realizimin e qëllimeve të Strategjisë. Sipas vlerësimeve të implementimit të kësaj strategjie, një prej të arriturave kyçe është

⁶ Gazeta zyrtare e RM-së, n.52 nga viti 16.04.2014

“mbindërtimi i kornizës ligjore dhe miratimi i disa ligjeve në mënyrë pjesëmarrëse”. Strategjia aktuale për bashkëpunimin e Qeverisë me sektorin qytetar (2012-2017) me Planin Aksionar për implementim është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në datën 16.6.2012. Qëllimi kryesor i Strategjisë është promovimi, mbështetja dhe avancimi i marrëdhënieve partnere midis Qeverisë dhe sektorit qytetar nëpërmjet masave të përforsimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në pesë sfera me prioritet: Sektor qytetar i zhvilluar dhe i qëndrueshëm; Pjesëmarrje aktive në përcaktimin e politikave, ligjeve dhe integrimin evropian; Zhvillimi ekonomik dhe kohezioni social; Aktivitet qytetar i përforsuar dhe mbështetja nga komuniteti; dhe Kornizë e përforsuar institucionale dhe praktika për bashkëpunim. Edhe pse strategjia para së gjithash ka të bëjë me organet e administratës shtetërore në nivel qendror, gjithsesi ajo bën thirrje që të vazhdojë bashkëpunimi midis njërive të vetëqeverisjes lokale me organizatat qytetare.

Dokumenti më i rëndësishëm strategjik rajonal në rajonin jug-perëndimor ku bën pjesë edhe Komuna e Strugës është “Programi për zhvillimin e rajonit jugperëndimor të planifikimit 2010 -2015”. Gjithsesi, në këtë program nuk ka masë eksplicite dhe asnjë aktivitet me të cilin do të stimulohej ose përmirësohej pjesëmarrja qytetare në bartjen e politikave rajonale dhe/ ose lokale. Edhe pse në program është theksuar se *“është i nevojshëm komunikimi midis bartësve themelor të politikave të zhvillimit rajonal, si edhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm siç janë biznes sektori, dhomat e ndryshme, asociacionet dhe shoqatat qytetare për harmonizimin e politikave dhe aktiviteteve të cilat kanë ndikim të rëndësishëm mbi zhvillimin rajonal”*, sektori qytetar paraqitet si bashkëbartës i implementimit vetëm në një numër të vogël të aktiviteteve të parashikuara.

Analiza fillestare tregoi se në këtë moment Komuna e Strugës nuk posedon dokumente të vlefshme me rëndësi strategjike. Komuna ka përpiluar dy dokumente strategjike: Planin Strategjik për Zhvillimin e Komunës së Strugës dhe Planin Aksionar për Strategjinë për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Komunës së Strugës, por edhe të dy dokumentet e përfshijnë periudhën 2007 – 2011. Në këto dokumente në sferën strategjike cilësia e jetës, qëllimi strategjik 5 (qytetarët janë më aktivë dhe me të aftë të marrin pjesë në zhvillim në aspektet e cilësisë së jetës

në komunë dhe rrethinën e saj) në mënyrë të drejtpërdrejtë ka të bëjë me sektorin qytetar, ndërsa qëllimi zhvillues përkatës definojnë formimin e grupeve komunale dhe qytetare, të fuqizuara dhe të lidhura në forume të cilët do të shërbejnë si kanal nëpërmjet të cilëve qytetarët do të mund të kontribuojnë në përcaktimin dhe arritjen e qëllimeve zhvillimore.

Proceset e decentralizimit dhe bashkëngjitja e RM-së në Bashkimin Evropian (BE) gjithashtu kontribuojnë në përcaktimin e kornizës politike-legjislative. Programi për realizimin e procesit të decentralizimit dhe zhvillimit të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë 2011 – 2014, thekson se të gjitha aktivitetet e parashikuara kanë për qëllim të ngrenë nivelin institucional të realizimit të procesit të decentralizimit dhe pjesëmarrjen e faktorëve kyç, përfshirë këtu edhe shoqërinë qytetare.

Prej këtyre të dhënave ekonomike vërehet se pjesa jugperëndimore kryesisht, dhe në kuadër të saj edhe Komuna e Strugës, është nën masatren e RM-së për shumë tregues edhe atë: PBV për banor, punësimi, investimet në mjetet themelore, etj. Kjo domethënë se rajoni i planifikimit në të cilin bën pjesë Struga është në mesin e më të varfërve në RM. Madje edhe nëse realizohen shkallët e parashikuara të zhvillimit në nivel kombëtar, situata nuk do të përmirësohet me automatizëm. Për këtë gjë do të nevojiten masat speciale për zhvillimin ekonomik lokal dhe angazhimi i potencialit të përgjithshëm lokal në sektorin publik, biznes sektorin dhe sektorin qytetar. Popullata në Komunën e Strugës shënon një rritje stabile të butë në dhjetëvjetorin e fundit si edhe barspeshë gjinore. Komuna është një komunitet multikulturor dhe multi-etnik me traditë të bashkëjetesës dhe ndihmë të bashkëqytetarëve.

Mediat e reja (fejsbuk, tuitar, flickr, jutjub...) paraqesin mundësi të shkëlqyeshme për komunën dhe SQ sepse nëpërmjet të tyre me shpenzime shumë më të ulëta të shpallin informata të shumta për aktivitetet, të shpalosin porositi të tyre deri te qytetarët, të shpalosim dokumente, fotografi dhe video materiale, të organizohen onlajn biseda me qytetarët ose me grupe të tjera qëllimore, të organizohen uebinare, forume dhe ngjashëm.

Faktorët e brendshëm

Komunën e udhëheqin Kryetari i komunës dhe Këshilli i Komunës i cili numëron 27 anëtarë. Administrata e Komunës në Strugë është e organizuar në 7 sektorë të koordinuar nga Sekretari i komunës. Në shfrytëzim zyrtar në komunë janë gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe. Struktura organizative nuk përfshin sektor ose departament të veçantë për bashkëpunimin me sektorin qytetar dhe i njëjtë është në kompetencën e një personi të emërtuar i cili në të njëjtën kohë është edhe Udhëheqës i sektorit. Komuna nuk ka regjistër të të gjitha shoqatave të regjistruara të qytetarëve me seli në Strugë, por ka të dhëna për ato organizata me të cilat ka bashkëpunuar dhe/ ose të cilët kanë fituar mjete financiare nga komuna.

Nuk ekzistojnë procedura zyrtare as për bashkëpunimin me shoqatat lokale qytetare, si edhe as politika lokale për stimulimin e përfshirjes së shoqërisë qytetare në bartjen e politikave lokale. Gjithsesi, në bazë ad-hok, komuna bashkëpunon me shoqata në përpilimin e projekt aplikimeve të përbashkëta dhe/ ose realizimin e projekteve të financuar nga donatorët e huaj (shembull Forumi në bashkësi). Format më të shpeshta të komunikimit të administratës komunale me SQ janë e-mail, bisedat telefonike, kontakte të drejtpërdrejta të përditshme dhe takimet të dedikuara me organizatat aktive në sferën konkrete. Informatat nga komuna më se shpeshti komunikohen nëpërmjet të ueb faqes të komunës, ndërsa një pjesë më e vogël e informatave të rëndësishme edhe nëpërmjet të mediave. Komuna organizon takime me qytetarët sipas iniciativës vetjake në varësi prej nevojave aktuale në sfera të caktuara (p.sh. debate publike gjatë bartjes së buxhetit). Puna e këshillit është publike dhe mbledhjet janë të hapura për të gjithë të interesuarit. Një pjesë e materialeve si edhe Gazetave zyrtare shpallen në ueb-faqen e komunës, por gjithsesi duhet të theksohet se e njëjta nuk azhurnohet rregullisht dhe nuk ofron informata të mjaftueshme dhe në kohë të duhur me interes për qytetarët dhe në veçanti për sektorin qytetar.

Shpërndarja e mjeteve financiare prej buxhetit të komunës për mbështetjen e SQ-së realizohet nëpërmjet shpalljes së Thirrjes publike për dorëzimin e projekteve, në të cilën përcaktohen sferat e interesit,

kushtet dhe dokumentet e nevojshme për dëshmimin e kapacitetit të organizatave. Ndjekja e implementimit të mjeteve financiare të dhëna kryhet nga ana e komisionit të formuar nga komuna, i cili dorëzon raportin për aktivitetet e realizuara dhe mjetet e shpenzuara deri të Këshilli komunal. Por, ky komision nuk ka përcaktuar procedura dhe mekanizma zyrtar për kontrollin financiar të mjeteve financiare të shpenzuara prej shoqatave qytetare e as sistem për monitorim. Gjatë vitit 2013, Komuna e Strugës ka ndarë rreth 10 milionë denarë për sektorin qytetar nëpërmjet të programeve për sport (5 milionë denarë), kulturë (2 milionë denarë) ZHEL (3 milionë denarë) dhe për programin për Kryetarin e komunës (177.000 denarë). Duke pasur parasysh se buxheti i përgjithshëm vjetor i komunës është rreth 650 milionë denarë, të dhënat tregojnë se Komuna e Strugës ndan rreth 1,5% prej buxhetit të përgjithshëm për mbështetjen e sektorit qytetar.

Edhe përkrah numrit të madh të organizatave qytetare të regjistruara, nuk janë të gjitha aktive në mënyrë të njëjtë. Në një numër të vogël të organizatave ka personel të punësuar të përhershëm dhe kryesisht ekzistojnë nëpërmjet të realizimit të projekteve, dhe vetëm një numër i vogël ka siguruar ekzistencë të qëndrueshme institucionale. Fokusi i tyre kryesisht është në mbrojtjen e mjedisit jetësor, të drejtave të njeriut, rinisë dhe kulturës, edukimin e femrave, sociale dhe integrimet e BE-së. Një shoqatë e qytetarëve ka fituar statusin me interes publik (ShQ “Porosi e Re”) e cila punon në sferën sociale, ndërsa për momentin edhe një organizatë është me fokus të zhvillimit të qëndrueshëm dhe është në procesin e marrjes së statusit të tillë (ShQ “Qendra për Zhvillim”).

HARTA STRATEGJIKE

Harta strategjike jep pamje të plotë të lidhshmërisë shkak-pasojë të prioriteteve të Komunës së Strugës në arritjen e vizionit për bashkëpunimin me sektorin qytetar deri në vitin 2020 nëpërmjet të katër perspektivave:

- Qytetarët e kënaqur,
- Sigurimi i shërbimeve,
- Përforcimi i kapaciteteve; dhe
- Menaxhimi me buxhetin.

Në bazë të analizave gjithëpërfshirëse në secilën prej perspektivave (shiko Shtojcat) janë definuar qëllimet prioritare strategjike për secilën perspektivë në veçanti.

HARTA STRATEGJIKE E KOMUNËS SË STRUGËS PËR BASHKËPUNIMIN ME SEKTORIN QYTETAR 2015-2020

VIZIONI:

Sektori qytetar në Strugë është partner kryesor i administratës për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mjediset urbane dhe rurale duke shfrytëzuar parimet e demokracisë pjesëmarrëse.

QYTETARËT E KËNAQUR:

SQ i rrjetëzuar në mënyrë aktive merr pjesë në proceset e miratimit të politikave/ vendimeve në nivel lokal

Përmirësimi i sigurimit të shërbimeve lokale me shfrytëzimin e kapaciteteve të SQ

SIGURIMI I SHËRBIMEVE:

Vendosja e sistemit intern efikas dhe të qëndrueshëm për bashkëpunim të suksesshëm me SQ

Vendosja e sistemit funksional dhe transparent për qasje deri te informatat

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE:

Përforcimi i përbashkët sistematik dhe i vazhdueshëm i administratës komunale dhe SQ

MENAXHIMI ME BUXHETIN:

Rritja e burimeve të jashtme të mjeteve për mbështetjen e projekteve të SQ

Sigurimi i konsistencës në pjesën e buxhetit komunal të dedikuar për SQ

Efikasiteti i rritur në shfrytëzimin e buxhetit të komunës për SQ

PARIMET/ VLERAT:

Barazi, Transparencë, Llogaridhënie, Pjesëmarrje, Profesionalizëm, Inoviteti, Ligjshmëri, Etikë, Partneritet

PRIORITETET DHE MASAT STRATEGJIKE TË KOMUNËS SË STRUGËS PËR BASHKËPUNIMIN ME SEKTORIN QYTETAR

7.1 Menaxhim me Buxhetin

- **PF1:** rritja e burimeve të jashtme të mjeteve për mbështetjen e projekteve të SQ-së
- **PF2:** konzistencë në pjesën e buxhetit komunal të dedikuar për SQ
- **PF3:** efikasiteti i shtuar në shfrytëzimin e buxhetit të komunës për SQ

Ana e vetme e fuqishme e komunës së Strugës lidhur me perspektivën financiare është eksperiencia e deritanishme prej mbështetjes së rregullt financiare e cila ndahet nga buxheti i komunës për SQ. Gjithsesi, edhe përkrah praktikës shumëvjeçare për financimin e SQ-së një pjesë e vogël e buxhetit shfrytëzohet për këtë qëllim që faktikisht është edhe anë e dobët nga kjo perspektivë. Kjo duhet të tejkalohet me sigurimin e burimeve të jashtme shtesë të financimit (për shembull, me shfrytëzimin e një pjesë të mundësive, ashtu siç janë: qasja deri të fondet e BE-së dhe fondet e tjera për bashkëpunim ndërkuftar, stimulimi i mbështetjes nga sektori privat nëpërmjet të lehtësimeve të caktuara financiare, dhe miratimi i aktit obligues për shpërndarjen e mjeteve nga buxheti i RM-së), si edhe sigurimi i konsistencës dhe parashikimit të mjeteve buxhetore të cilat do të dedikohen për sektorin qytetar. Efikasiteti i shtuar i shfrytëzimit të mjeteve buxhetore mund të sigurohet nëpërmjet të vendosjes së kriterëve dhe procedurave për shpërndarjen e granteve për SQ me çka do të rritej efikasiteti, ndërsa në të njëjtën kohë do të zvogëlohej subjektivizmi gjatë shpërndarjes së granteve për SQ. Sistemi i monitorimit madje do të siguronte vlerësimin real të ndikimit të aktiviteteve të realizuara dhe kontrollin financiar të shpenzimit të mjeteve të dhëna. Kombinimi i suk-

sesshëm i anëve të fuqishme dhe mundësive dhe me adresimin përkatës të anëve të dobët në masë të madhe do të zvogëlojë ndikimin negativ të krizës së përgjithshme ekonomike dhe zvogëlimin e buxhetit lokal që është zbuluar si rreziku i vetëm, por i rëndësishëm në këtë perspektivë.

7.2 Zhvillimi i kapaciteteve

- **MZh1:** Përforcimi i përbashkët sistematik dhe i vazhdueshëm i kapaciteteve të administratës komunale dhe SQ

Numri i vogël i anëve të fuqishme në perspektivën e mësimi dhe zhvillimit sugjeron se është e nevojshme të punohet në krijimin e klimës të volitshme dhe adaptimin e proceseve të brendshme organizative për përforcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të administratës komunale. Prandaj, ana e fuqishme e identifikuar (eksperienca e dëshmuar për realizimin e projekteve) duhet në mënyrë përkatëse të kombinohet me mundësitë ekzistuese (SQ aktive me eksperiencë të dëshmuar, si dhe eksperiencë praktike të shoqatës lokale e cila ka statusin me interes publik) gjatë përcaktimit të strategjisë për zhvillimin e kapaciteteve. Prej këtu, prioriteti i përcaktuar strategjik është **përforcimi i përbashkët i vazhdueshëm sistematik i kapaciteteve të administratës komunale dhe SQ**. Me qasjen e tillë të përforcimit të përbashkët të kapaciteteve do të minimizohen ndikimet e naive të dobëta dhe në të njëjtën kohë do të punohet në eliminimin e tyre. Për shembull, komuna ka mirëkuptim më të madh për punën dhe aktivitetet e SQ-së, do të zmadhojë informimin për realizimin e strategjisë kombëtare për bashkëpunim me SQ, ndërsa do të stimulojë këmbimin e informatave për trashëgiminë kulturore komunale. *Numri i madh i anëve të dobëta në këtë perspektivë, ngjashëm si edhe te perspektiva e proceseve të brendshme, tregon se fuqizimi i kapaciteteve të administratës dhe përmirësimi i proceseve institucionale janë kriteret kyçe për përpilimin e prioriteteve dhe masave të strategjisë.*

7.3 Sigurimi i shërbimeve

- **SSh1:** Vendosja e sistemit intern efikas dhe të qëndrueshëm për bashkëpunim të suksesshëm me SQ
- **SSh2:** Vendosja e sistemit funksional dhe transparent për qasjen deri te informatat

Në perspektivën e sigurimit të shërbimeve, duhet të shfrytëzohet ekipimi i mjaftueshëm i administratës (dygjuhësore), marrëdhëniet e mira të vendosura me rajonet ndërkufitare, si edhe eksperiencia në bashkëpunimin me donatorët nga vendi dhe nga jashtë nga njëra anë, dhe numri i madh i mundësive (potenciali i SQ-së për marrjen e statusit me interes publik, bashkëpunimi midis pushtetit qendror dhe pushtetit lokal në implementimin e strategjisë për bashkëpunim me SQ, pozita e mirë gjeografike, kapacitetet e ndërtuara profesionale të SQ-së) të cilat janë identifikuar për përmirësimin dhe rritjen e numrit dhe cilësisë së shërbimeve/ aktiviteteve të Komunës së Strugës për bashkëpunim me sektorin qytetar. Për këta arsye është e nevojshme që të vendoset një sistem intern efikas dhe i qëndrueshëm për bashkëpunim të suksesshëm me SQ.

Gatishmëria e administratës komunale për bashkëpunim, vendosja e bashkëpunimit të mirë me SQ, praktika e takimeve të rregullta me qytetarët dhe mediat duhet të shfrytëzohen për vendosjen e sistemit funksional dhe transparent për qasjen deri te informatat. Kjo strategji në mënyrë të duhur do t'i adresojë anët e dobëta dhe rreziqet dhe do të zvogëlojë ndikimin e tyre negativ (për shembull, ueb faqja jofunksionale, animimi i shtuar dhe përfshirja e personave të rinj të edukuar me çka do të pengohet derdhja e tyre dhe emigrimi).

7.4 Qytetarët e kënaqur

- **QK1:** SQ i rrjetëzuar që merr pjesë në mënyrë aktive në proceset e bartjes së politikave/ vendimeve në nivel lokal
- **QK2:** Përmirësimi i sigurimit të shërbimeve lokale me shfrytëzimin e kapaciteteve të SQ-së

Qëllimet prioritare strategjike të identifikuar në perspektivën e klientit, gjegjësisht “qytetarët e kënaqur” duhet të mundësojnë arrijtjen e vizionit nëpërmjet të strategjive të cilat duhet të burojnë me shfrytëzimin e anëve të fuqishme dhe shfrytëzimin e mundësive të cilat janë më të numërta dhe më me ndikim në krahasim me anët e dobëta dhe rreziqet. Praktika për sigurimin e mbështetjes logjistike për SQ për përpilimin e projekt aplikimeve dhe takimet e rregullta me qytetarët (anët e fuqishme), duhet të shfrytëzohen me numrin e madh të OJQ-ve lokale dhe marrëdhëniet e mira ndëretnike (mundësitë) dhe të stimulohet rrjetëzimi i SQ në proceset e miratimit të politikave/ vendimeve me rëndësi lokale. Në këtë mënyrë do të stimulohet bashkëpunimi i përbashkët dhe këmbimi i ndërsjellë i eksperiencës dhe mbështetja në punë dhe veprimin e tyre të përditshëm.

Kërcënimet të cilat para së gjithash janë rezultat i mos(bashkëpunimit) të kushtëzuar politik me pushtetin qendror, si edhe moszbatimi përkatës i ligjeve dhe rregullave duhet të tejkalohet me përforcimin e bashkëpunimit me sektorin qytetar dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të SQ-së për sigurimin e përmirësuar të shërbimeve lokale.

HARTA E BALANCUAR E TREGUESVE NË KOMUNËN E STRUGËS PËR BASHKËPUNIMIN ME SEKTORIN QYTETAR

Harta e Balancuar e Treguesve mundëson që më mirë të ndiqet se cilat hapa strategjike do t'i ndërmarrë Komuna e Strugës në periudhën 2015 – 2020 dhe cilat rezultate duhet të arrihen që të realizojë vizionin e saj për bashkëpunimin me sektorin qytetar në komunë siç është paraqitur në tabelën më poshtë. Me qëllim që të sigurohet fokusi dhe prioritizimi më i mirë strategjik në implementimin e aktiviteteve, deri te secili prej katër aspekteve të strategjisë dhe prioriteteve strategjike në kllapa është dhënë rëndësia (vlefshmëria) e tyre relative për secilin aspekt dhe prioritetet strategjike përkatëse të shprehur me përqindje. Vlera e përqindjes tregon rëndësinë e secilit aspekt në krahasim me tre aspektet tjera, si edhe rëndësinë e secilit prioritet strategjik në kuadër të katër aspekteve. Përqindja më e madhe domethënë fokus më i madh strategjik dhe rëndësi më e madhe për këtë aspekt ose prioritet.

HARTA STRATEGJIKE E KOMUNËS SË STRUGËS PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN QYTETAR 2015-2020

VIZIONI:

Sektori qytetar në Strugë është partner kryesor i administratës për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mjediset urbane dhe rurale duke shfrytëzuar parimet e demokracisë pjesëmarrëse.

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore	Masat/ Iniciativat
QYTETARËT E KËNAQUR (25,9%)			
QK1: SQ i rrjetëzuar në mënyrë aktive merr pjesë në proceset e miratimit të politikave/ vendimeve në nivel lokal (14,6%)	1.1 Rrjetë funksionale lokale e OJQ-ve	1 rrjetë lokale	1.1 Krijimi i mekanizmave për bashkëpunim midis komunës dhe sektorit qytetar
	1.2 Marrëdhënia midis propozimeve të pranura dhe të propozuara nga SQ-ja	35%	1.2 Përfshirja sektorit qytetar në procesin e krijimit të politikave lokale 1.3 Ngritja e vetëdijes te qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre më aktive në SQ
QK2: Përmirësimi i sigurimit të shërbimeve lokale me shfrytëzimin e kapaciteteve të SQ (11,3%)	2.1 Numri i OJQ-ve të cilave u është dhënë sigurimi i shërbimeve komunale	2	2.1 Përcaktimi i ofertës dhe kriterëve për sigurimin e shërbimeve nëpërmjet SQ-së në sfera të veçanta
	2.2 Numri i OJQ-ve të cilat kanë fituar “statusin me interes publik”	2	2.2 Vendosja e sistemit të përfshirjes së SQ-së në sigurimin e shërbimeve komunale 2.3 Vendosja e sistemit për mbështetjen e SQ-së për sigurimin e shërbimeve dhe arritjen e “statusit me interes publik” 2.4 Sistem për mobilizimin e resurseve prej SQ-së për sigurimin e përmirësuar të shërbimeve

HARTA STRATEGJIKE E KOMUNËS SË STRUGËS PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN QYTETAR 2015-2020

VIZIONI:

Sektori qytetar në Strugë është partner kryesor i administratës për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mjediset urbane dhe rurale duke shfrytëzuar parimet e demokracisë pjesëmarrëse.

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore	Masat/ Iniciativat
SIGURIMI (LIVRIMI) I SHËRBBIMEVE (20,9%)			
<p>SSH1: Vendosija e sistemit inter efikas dhe të qëndrueshëm për bashkëpunim të suksesshëm me SQ (11,6%)</p>	<p>1.1 Strukturë përkatëse organizative dhe sistematizim të vendeve të punës</p> <p>1.2 Numri i partneriteteve të realizuar me SQ</p>	<p>Sektor (departament) i themeluar për bashkëpunim me SQ</p> <p style="text-align: center;">5</p>	<p>1.1 Vendosija e strukturës funksionale organizative për bashkëpunim me SQ</p> <p>1.2 Formalizimi i planifikimit pjesëmarrës dhe zbatimi i aktiviteteve</p> <p>1.3 Vendosija e koordinimit intern efektiv ndërsektorial dhe bashkëpunim të jashtëm ndërinstinucional</p>
<p>SSH2: Vendosija e sistemit funksional dhe transparent për qasje deri te informatat (9,3%)</p>	<p>2.1 Ueb-faqe komunale funksionale</p> <p>2.2 Numri i takimeve dhe forumeve me SQ</p> <p>2.3 Qendër funksionale për Mbështetjen e SQ-s¹</p>	<p>www.struga.gov.mk</p> <p style="text-align: center;">12 / vit</p> <p>3 të punësuar me orar të plotë pune</p>	<p>2.1 Krijimi i bazës komunale së të dhënave për organizata joqeveritare dhe mekanizmat për ndjekjen e aktiviteteve të SQ</p> <p>2.2 Krijimi i institucionalizimit të sistemit për komunikim të rregullt dhe përfshirjen e organizatave qytetare</p> <p>2.3 Procedura zyrtare për informimin e rregullt për aktivitetet e Këshillit</p> <p>2.4 Themelimi i Qendrës për mbështetjen e SQ-s²</p>

Harta e Balancuar e Treguesve në Komunën e Strugës për bashkëpunimin me sektorin qytetar

HARTA STRATEGJIKE E KOMUNËS SË STRUGËS PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN QYTETAR 2015-2020

VIZIONI:

Sektori qytetar në Strugë është partner kryesor i administratës për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mjediset urbane dhe rurale duke shfrytëzuar parimet e demokracisë pjesëmarrëse.

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore	Masat/ Iniciativat
ZHVILLIMI I KAPACITETEVE (16,5%)			
ZhK1: Përforcimi i përbashkët sistematik dhe i vazhdueshëm i administratës komunale dhe SQ (16,5%)	1.1 Numri i trajnimeve të përbashkëta të organizuara për administratën komunale dhe SQ	10 trajnime/ vit	1.1 Vendosja e sistemit për trajnim të vazhdueshëm të administratës
	1.2 Numri i programeve të përpiluara	5	1.2 Programe për trajnimin e administratës: bashkëpunimi ndër-komunal dhe ndër-institucional, përpilimi i projekt aplikimeve, shfrytëzimi i TIK moderne, shkathtësitë komunikuese 1.3 Zhvillimi i partneriteteve të komunës me SQ për bashkëpunim të përmirësuar me institucionet e tjera kompetente dhe partnerët 1.4 Vendosja e koordinimit intern efektiv ndër-sektorial 1.5 Programi për ndryshimet organizative

HARTA STRATEGJIKE E KOMUNËS SË STRUGËS PËR BASHKËPUNIM ME SEKTORIN QYTETAR 2015-2020

VIZIONI:

Sektori qytetar në Strugë është partner kryesor i administratës për përmirësimin e cilësisë së jetesës në mjediset urbane dhe rurale duke shfrytëzuar parimet e demokracisë pjesëmarrëse.

Prioritetet	Treguesit	Vlerat qëllimore	Masat/ Iniciativat
MENAXHIMI ME BUXHETIN (36,8%)			
MB1: Rritja e burimeve të jashtme të mjeteve për mbështetjen e projekteve të SQ (16,5%)	1.1 Shuma e mjeteve jobuxhetore për mbështetjen financiare të SQ	10.000.000 mkd/ vit	1.1 Krijimi i parakushteve më të volitshme administrative dhe parakushteve të tjera për tërheqjen e kapitalit privat 1.2 Vendosja e sistemit për ko-financimin e projekteve dhe aktiviteteve me biznes komunitetin dhe sektorin joqeveritar (PPP) 1.3 Intensifikimi i bashkëpunimit me donatorët e huaj dhe fondet për partneritet me SQ
MB2: Konsistencë në pjesën e buxhetit komunal të dedikuar për SQ (10%)	2.1 Përqindja fikse prej buxhetit themelor komunal e dedikuar për SQ	3%	2.1 Programi shumëvjeçar financiar për mbështetjen e SQ
MB3: Efikasiteti i rritur në shfrytëzimin e buxhetit të komunës për SQ (10,3%)	3.1 Kriteri i vendosur për shpërndarjen e mjeteve buxhetore 3.2 Sistemi i vendosur për monitorim	Kriteret e miratuar nga Këshilli Sistemi i monitorimit i miratuar nga Këshilli	3.1 Metodologjia për ndarjen e buxhetit komunal për financimin e SQ 3.2 Përcaktimi i kriterëve tërësorë dhe precizë për financimin e SQ 3.3 Vendosja e sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e granteve të dhëna për SQ

PARIMET/ VLERAT:

Barazi, Transparencë, Llogaridhënie, Pjesëmarrje, Profesionalizëm, Inovacioni, Ligjshmëri, Etikë, Partneritet

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Harta e Baraspeshuar (balancuar) e Treguesve paraqet një vegël të rëndësishme për monitorimin e implementimit të Strategjisë së Komunës së Strugës për bashkëpunimin me sektorin qytetar 2015-2020, për shkak të asaj se të gjitha qëllimet dhe masat – financiare dhe jofinanciare – burojnë nga vizioni. Realizimi i përfitimeve të komunës prej TKI-së ndiqen nëpërmjet raporteve, diskutimeve, komunikimeve, azhurnimeve dhe veprimeve. Raportet të komunës prej TKI-së përpilohen në afat tremujor, sipas radhitjes së caktuar. Gjatë kësaj, në procesin e ndjekjes së tyre rolin e kanë kryetari i komunës, sekretari dhe udhëheqësit e sektorëve të cilët janë përgjegjës për implementimin e masave dhe aktiviteteve për qëllimet përkatëse prioritare strategjike.

Roli i kryetarit të komunës është që të sigurojë personin përgjegjës për ndjekjen e implementimit të Strategjisë së Komunës së Strugës për bashkëpunimin me sektorin qytetar 2015-2020. Personi përgjegjës për ndjekjen e implementimit të strategjisë lidhur me arritjen e vlerave qëllimore kryen aktivitetet vijuese:

- koordinon grumbullimin e informatave prej sektorëve;
- informon udhëheqësit e sektorëve për afatet përfundimtare për dorëzimin e raporteve të sektorëve;
- konsolidon raportet prej sektorëve në një Raport të vetëm për TKI të Komunës Strugë për bashkëpunimin me sektorin qytetar;
- dorëzon raportet e konsoliduar deri te sekretari, kryetari i komunës dhe këshilltarët e Komunës së Strugës;
- ndjek dhe realizon procesin e futjes së ndryshimeve në TKI.

Roli i udhëheqësve të sektorëve në procesin e ndjekjes së arritjeve të vlerave qëllimore për TKI në Komunën e Strugës për bashkëpunimin me sektorin qytetar përbëhet prej:

- përcaktimit të personit përgjegjës për secilin tregues prej prioriteteve strategjike të cilat janë pjesë e qëllimeve të sektorit;
- përpilimit të raporteve për realizimin e aktiviteteve në nivel të sektorit;
- pjesëmarrjes në revidimin e treguesve për secilin qëllim prioritar që është pjesë e qëllimeve të sektorit.

Personi përgjegjës për secilin tregues prej qëllimeve prioritare strategjike në procesin e ndjekjes së arritjeve të vlerave qëllimore prej TKI realizon aktivitetet vijuese:

- koordinon grumbullimin e informatave në kuadër të sektorit;
- informon udhëheqësin e sektorit për afatet përfundimtare për dorëzimin e raportit të sektorit;
- përpilon raportin e vetëm të sektorit dhe e dorëzon pranë udhëheqësit të sektorit;
- ndjek dhe realizon procesin e futjes së ndryshimeve në TKI.

Përveç për monitorim, TKI do të shfrytëzohet edhe për vlerësimin e realizimit të planit strategjik, me qëllim që të përcaktohet: se a janë realizuar qëllimet e planifikuara të politikës në mënyrë efikase dhe deri në cilën shkallë janë paraqitur efektet e padëshirueshme. Prishja ose ndërprerja e lidhshmërisë së shkakut dhe pasojës së prioriteteve, si edhe mos arritja e vlerave qëllimore të treguesve për prioritetet e veçanta do të japë informata për atë se çfarë ndryshimesh duhet të bëhen në planin strategjik..

